

**VENDIM**  
**Nr. 345, datë 29.4.2015**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR APARATIN  
E KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Aparatit të Kryeministrit, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, t’i shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korente”, për funksionimin e grupit Task-Forcë “Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore”, në kuptim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës, për vitin 2015.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**